



Nr. 5384

Nr. 6181 Prot.

Tiranë më 03.08.2022

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit

Për dajeni : Person Fizik "Henrik Lezi"

Adresa: Rr. "Jordan Misja", pall "Gener 2", shkalla D/5, kati 1, ap. 1,
Tiranë

ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A.

Në Tiranë, sot më datë 03.08.2022,

Unë **Edvin Malotaj**, përmbarues gjyqësor privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me çertifikatë Nr. 106, datë Maj 2012, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Vendimit Nr. 2971, datë 05.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 17.06.2022, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Vendimit Nr. 2971, datë 05.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

Kreditor : ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A. (ish Telekom Albania Sh.A.)

Debitor : Person Fizik "Henrik Lezi"

Me Objekt : *Kthim shume*

Me Vendimin Nr. 2971, datë 05.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur:

"Pranimin e kërkesë-padisë.

Detyrimin e të paditurit Henrik Lezi PF t'i paguajë palës paditëse Shoqëria "ONE TELECOMMUNICATIONS" sha., shumën prej 176,043 lekë, si detyrim i papaguar nga shërbimi telefonik celular.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur".

Debitorit i është komunikuar lajmërimi për ekzekutim vullnetar por nuk ka marrë asnjë masë për shlyerjen e detyrimit. Në vijim ka rezultuar se shuma totale e detyrimit është sekuestruar në llogarinë bankare të palës debitore pranë Raiffeisen Bank.

Sa më sipër bazuar në K.Pr.Civile, Ligjit Nr. 26/2019 datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" dhe Udhëzimit Nr. 385/7, datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat"

URDHËROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit të heqë masën e sekuestros konservative mbi aktivet që debitorët e mëposhtëm zotërojnë të regjistruara pranë jush:
 - **Person Fizik "Henrik Lezi" me Nipt L02326008L**, për ekzekutimin e Vendimit Nr. 2971, datë 05.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, **duke revokuar urdhrin tonë të mëparshëm Nr.3929 Prot., datë 18.07.2022.**
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Përmbarues Gjyqësor Privat

Edvin Malótaj

